



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 3220 prot.

Himarë, më 22.04 . 2025

VENDIM

Nr. 05 datë 22.04 . 2025

PËR MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“,neni 17,56 dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak,miratuar me VKB, Nr. 33 datë 28.07.2023 neni 27. Kryesia e këshillit në mbledhjen e datës 22.04 .2025

VENDOSI:

- 1.Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e Këshillit Bashkiak e cila do të mbahet më datë 06.05 .2025.
- 2.Ngarkohet sekretari këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
- 3.Ngarkohet sekretari këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës si dhe materialet relevante të mbledhjes tek secili këshilltar ,tek kryetari Bashkisë,deputetët e qarkut,tek personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë ,si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltarë dhe tek kryetari Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Mirëza Gjiculi

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Elena Memubaj  
Elena

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Timoteo Gerothupi

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Aranda Dhimani

Sekretar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më 22.04.2025

**LËNDA; BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR \_\_, DATË 22.04.2025 ,MIRATUAR NGA KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK NË MBLEDHJEN E DATËS 22.04.2025 “ PËR MIRATIMIN PARAPARAK TË RENDIT TË DITËS DHE PËRCAKTIMIN E DATËS SË MBLEDHJES PËR KËSHILLIN BASHKIAK,MUAJI PRILL 2025”.**

Kryesia e këshillit vendosi se mbledhja e muajit prill do të mbahet më datë 06.05.2025 ,ora 10:30, me rend dite si më poshtë;

1. Shqyrtimi kërkesave, ankesave të qytetarëve të Bashkisë Himarë.
2. Analizë nga drejtoria e bujqësisë , pyjeve , kullotave dhe ujëtjes , mbi masat e marra në sektorin e bujqësisë , sistemimi dhe investimi në kanalet kulluese e vaditëse , arritjet dhe sfidat si dhe problematikat e hasura në këtë sektor .
3. Interpelancë drejtoria e IMT , mbi ndërtimet dhe masa e marra për vitin 2025 , në territorin e Bashkisë Himarë.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 31 mars , nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike”.

**Të ndryshme**

**Sekretari**

**Elena Memushaj**